РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ДКСК — ДРЖАВНА КОМИСИЈА ЗА СПРЕЧУВАЊЕ НА КОРУПЦИЈАТА
KSHPK — KOMISIONI SHTETËROR PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) nenit 40 paragrafi 3 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, (në tekstin e mëtejshëm: KSHPK) duke vepruar në bazë të lëndës së formuar me vet iniciativë, në seancën e 82-të, të mbajtur më datë 14.02.2023 morri,

## VENDIM

Procedura e KSHPK-së sipas lëndës me numër 08-4856/1 datë 12.11.2021, e formuar me vetiniciativë , për shkeljen e dispozitave të nenit 82 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit nga ___________________________, anëtare e Bordit Drejtues i ____________________,NDËRPRITET.

Komisioni për kundërvajtje në KSHPK ka miratuar vendimin numër 14-5974/4 të datës 28.11.2022, me të cilin i emëruari është shpallur përgjegjës dhe i është shqiptuar sanksion gjobë prej 400 euro në kundërvlerë në denarë.

KSHPK -ja nuk ka elemente për veprime të mëtejshme në rastin konkret.

Vendimi në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Lënda me numër 08-4856/1 datë 12.11.2021 është formuar me iniciativë të saj.

KSHPK-ja, nga gazeta Zyrtare numër 191 e vitit 2021, ka konstatuar se __________________________________________________ me Vendim nr. 14-8570/1, datë 30.07.2021, është shkarkuar nga detyra anëtar i Bordit Drejtues të ISHP ______________________________________________.

Nga të dhënat e saj, KSHPK-ja konstatoi se personi ___________________________________, brenda afatit të përcaktuar ligjor prej 30 ditësh nga dita e përfundimit të funksionit në fjalë, nuk ka dorëzuar fletë anketuese në KSHPK.

KSHPK-ja lëshoi dhe i dorëzoi personit të përmendur një urdhërpagesë kundërvajtëse me numër 08-5974/2 datë 16.06.2022 për shkelje nga neni 82 paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i dënueshëm sipas nenit 109 të të njëjtit. ligji.

Duke qenë se personi ________________________________ nuk ka vepruar me urdhërpagesë për kundërvajtje në afatin e paraparë me ligj, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës për kundërvajtje komisionit për kundërvajtje në KSHPK.

Komisioni për kundërvajtje në KSHPK ka miratuar vendimin numër 14-5974/4 të datës 28.11.2022, me të cilin i emëruari është shpallur përgjegjës dhe është dënuar me gjobë për kundërvajtje prej 400 euro në kundërvlerë në denarë.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Përgatiti:A.Ç.
Miratoi: Mr. Vladimir Georgiev anëtar në KSHPK

**KOMISIONI SHTETËRORË**
**PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT**
**NËNKRYETARE,**
**Katica Nikolovska**